

Jeton Sallahu
Dr. Gentrit Smakaj

DISA TË DHËNA TË REJA NGA BURIMET OSMANE PËR KALANË E VJETËR NË VUSHTRRI

Disa indikacione a rezultate të deritanishme rreth Kalasë së Vushtrrisë

Në ditët e sotme, kur flasim për qytetin e Vushtrrisë, zakonisht mendja e të gjithëve shkon tek antikiteti. Ndër monumentet identifikuese të saj mund të përmendim, atë që është quajtur me emra të ndryshëm si *Kalaja e Vjetër*, *Kalaja e Qytetit*, *Kalaja e Vushtrrisë*, apo që mund të haset edhe me ndonjë tjetër emërtim. Ç'është e vërteta trualli i sotëm i Vushtrrisë, ishte një vendbanim edhe në antikitet, madje jo i parëndësishëm, në të cilin jetoi popullata vendëse, ajo iliro-dardane, domethënë paraardhësja e popullatës së sotme shqiptare. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se kanë munguar praninë edhe të popullsive që nuk ishin iliro-shqiptare, të cilat kanë qenë numerikisht pakicë, pakica që janë edhe sot e kësaj dite. Kjo do të thotë se në ndërtimet e ndryshme që janë realizuar në qytetin që kemi në trajtim, rolin kryesor e ka pasur popullata shumicë, por pa anashkaluar këtu as ndikimet e popullsive të tjera që kanë qenë pakica, megjithëse ndonjëra prej tyre ka mundur në ndonjë periudhë të caktuar të ishte më e privilegjuar, natyrisht nëse ajo vinte nga perandoria/shteti sundues. Megjithatë, përmes studimit të monumentit që kemi në trajtim, pra *Kalanë* (nuk do t'ishte gabim të quhej as "*fortifikatë*", sepse brenda saj gjendet dhe një *kullë*, e cila shërbente për të vrojtuar), e kuptojmë njëkohësisht edhe rolin e etnisë iliro-shqiptare ndër epoka.

Në vazhdim do të skicojmë disa momente që mund të na sjellin informacione rreth *Kalasë*, a indikacione, apo më vonë edhe të dhëna më të sigurta rreth kohës së ekzistencës së saj:

E para, dihet tashmë se hapi i madh i zhvillimit të qytetarisë ilire ka ndodhur gjatë *shekujve IV-I p.e.s.*, e kjo do të thotë se vendbanime të

fortifikuara¹ ka pasur edhe në truallin e Dardanisë ilire. E përmendëm këtë të fundit, ngase brenda truallit të këtij shteti ka ekzistuar vendbanimi i sotëm i Vushtrrisë. Sipas autorit Emil Çershkov:

*“Politika e urbanizimit ka mundur të mbështetet vetëm mbi rrjetin ekzistues të vendbanimeve iliriane”.*²

Duke marrë parasysh këtë rrjedhë historie të vendbanimeve fortifikuese, ekziston mendimi se *Kalaja e Vushtrrisë* që ndodhet në qendër të qytetit, i takon tipit të objekteve që gjenealogjia i përcakton si të periudhës ilire³, duke vazhduar më pastaj në periudhat romake, bizantine, osmane⁴, e që vazhdon të ekzistojë deri në ditët e sotme.⁵

Duke mbetur te periudha e antikitetit e cila kap një periudhë jo të shkurtër kohore, dhe duke pasur parasysh faktin se *materiali lidhës i ndërtimeve* ishte i njohur veçanërisht te romakët, e duke e ditur se monumenti në trajtim kishte nën përpunim materialin e posa zënë në gojë⁶, na lënë të mendojmë se datimin e *Kalasë së Vjetër* duhet ta kërkojmë më shumë në kohën e *pas pranisë romake/bizantine*, sesa para pranisë së tyre.

E dyta, një opsion tjetër i kohëndërtimit të *Kalasë së Vjetër* vlerësohet ai i kapërcimit të antikitetit, respektivisht fillimit të kohës së mesjetës. Në këtë drejtim, si moment i mundësisë së ndërtimit të monumentit në fjalë, merret *epoka e perandorit bizantin, me origjinë ilire, Justinianit I*, domethënë e kemi fjalën për *shekullin VI*. Ne po përmendim disa arsye që tregojnë se monumenti që kemi në trajtim i takon kësaj periudhe dhe ato ndoshta mund të ngacmojnë logjikën e studiuesve për këtë. *a)* Në kohën që po flasim, Perandoria Bizantine, ku bënte pjesë edhe trualli i Vushtrrisë, vazhdonte të qëndronte, me gjithë sulmet e popujve të ndryshëm që e atakonin atë, e që në burime shpesh zihen në gojë me emrin “barbarë”,

1 Neritan Ceka, “Vendbanime protourbane në Ilirinë e Jugut” në revistën “Iliria studime dhe materiale arkeologjike” (VII-VIII, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore të Shqipërisë (RPSH) Qendra e Kërkimeve Arkeologjike, Tiranë, 1977-1978), f.251-252.

2 Emil Cershkov, Rimljani na Kosovu i Metohiji, cituar sipas Luan Përzhitja, Fatmir Peja, “Mbi disa tipare të zhvillimit kulturor në Dardaninë Perëndimore shek.I-IV në Hartën Arkeologjike të Kosovës”/Archaeological Map of Kosova I (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë, 2006), f.129-130.

3 Për më shumë, shih mendimin e historianit Bedri Xhema shprehur nga intervistimi i gazetarit Faik Shala të titulluar “Monumentet kulturo-historike duhet të ruhen nga vet populli” në gazetën “Dita” (E premtë, 21 prill 2000), f.17.

4 Luan Gashi, “Gërmimet arkeologjike dhe konservimet në Kalanë e Vushtrrisë” (Instituti Arkeologjik i Kosovës, Prishtinë, 2015), f.194-195.

5 Emin Sallahu, “Materiale të pabotuara të Kalasë së Vjetër në Vushtrri” (Vushtrri, 2010).

6 Emin Sallahu, “Materiale të pabotuara” (Prishtinë, 2021).

apo që njihen edhe me emërtime të tjera. Prandaj nevojitej investim edhe në mbrojtje, pra në ndërtimet e reja apo të bëheshin rindërtime mbi bazën e ndërtimeve të mëhershme; *b)* Kishte ndodhur një tërmet që ndërlidhet me vitin 518, e që kishte bërë dëmtime të rënda edhe në Dardani, siç na njofton Marcelin Comesi në veprën e tij “Chronicon”, ndaj nevojitej ndërmarrje shtetërore në rindërtime apo ndërtime të reja; *c)* Vetë perandori Justiniani I ishte me origjinë iliro-dardane,⁷ gjë që ndoshta e ka shtyrë edhe më tepër të interesohet për truallin e etnisë që vetë i takonte, prandaj edhe investimi në mbrojtje të këtij trualli, pa përjashtuar këtu interesimin e tij edhe për gjithë territorin e perandorisë që ai e përfaqësonte, kishte bërë që perandoria të ofronte më shumë për këtë pjesë. Ç’është e vërteta, me ndërtimet e rindërtimet, gjatë sundimit të perandorit në fjalë, si dhe me arkitekturën ushtarake të epokës bizantine në provincat e Iliricumit, na njih autori Prokopii i Çezaresë me veprën e tij “De Aedificis” (Mbi ndërtimet). Duket se ky aktivitet ishte shtrirë në qendra të mëdha në zonat përreth, pranë rrugëve të komunikimit Lissus-Naissus, apo të akseve rrugore të dorës së dytë.⁸ Megjithëkëtë, ne nuk mund të themi me siguri se u bë ndonjë investim në këtë kohë në *Kalanë e Vjetër në Vushtrri*. Në fakt, nuk e dimë as nëse ajo u ndërtua, apo u rindërtua, domethënë nuk e dimë nëse ajo ekzistonte apo filloi të ekzistojë nga ajo kohë ekdotej, sikurse nuk e dimë nëse u investua në ndonjë tjetër kala a fortifikatë, apo në ndonjë objekt tjetër që shërbente për mbrojtje të Vushtrrisë me rrethinën e saj... Duke iu referuar hulumtimit që i kemi bërë veprës së Prokopit që e përmendëm më sipër, nuk kemi arritur që përmes emrave të fortifikatave të kuptojmë më shumë rreth çështjes që kemi në trajtim.⁹

E treta, nga fundi i dekadës së parë dhe fillimi i dekadës së dytë të shekullit XXI, janë realizuar gërmime arkeologjike në *Kalanë e Vjetër në Vushtrri*, të udhëhequr nga arkeologët Dedë Palokaj e Luan Gashi.¹⁰ Madje, disa nga rezultatet e pabotuara që rrodhën nga këto gjurmime arkeologjike

7 Për çështjen e Comesit dhe origjinën e perandorit Justinian, shih: Milot Berisha, “Ulpiana e Dardanisë në dritën e hulumtimeve arkeologjike” në *“Gërmime dhe studime arkeologjike në Kosovë 2000-2012” (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta CXXXII, Seksioni i Shkencave Shoqërore, libri 43, Prishtinë, 2014), f.289-301.*

8 Luan Përzhita, “Vlera kronologjike e të dhënave të Prokopit mbi ndërtimet e Justinianit në Provincën e Dardanisë” në *“Gërmime dhe studime arkeologjike në Kosovë 2000-2012” (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta CXXXII, Seksioni i Shkencave Shoqërore, libri 43, Prishtinë, 2014), f.189-191.*

9 Procopii Caesariensis, “De aedificis 4”, libri IV, në grup autorësh përgatitës, “Ilirët dhe Iliria te autorët antikë” (Rilindja, Prishtinë, 1979), f.431-445.

10 Burim Rexhepi, Temë e masterit e titulluar “Valorizimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Vushtrrisë” (Prishtinë, 2020), f.26.

ne kemi pasur rast t'i botojmë ndokund tjetër.¹¹

Rezultatet nga gjurmimet arkeologjike megjithëse janë tejet të rëndësishme, nuk e saktësojnë në mënyrë të sigurtë datimin e monumentit që jemi duke trajtuar. Kjo ngase artefaktet e gjetura u takojnë periudhave të ndryshme, dhe kjo do të thotë se ka pasur disa shtresëzime, si p.sh., ndonjë artefakt është sjellë nga ndonjë vend tjetër, dhe më vonë është gjetur brenda kalasë. Prandaj, edhe gjatë një konsulte që kemi pasur me arkeologun që e përmendëm më lart, i cili u kishte prirë gjurmimeve arkeologjike, ai theksoi se saktësisht nuk kemi arritur të saktësojmë ndërtimin e *Kalasë së Vjetër në Vushtrri*, megjithëse krahas dy opsioneve të para që i kemi përmendur, ekziston edhe *opsioni i tretë, domethënë ai i kohës bizantine*¹². Por tani shtrohet pyetja se çfarë nënkuptohet me kohën bizantine. Kohë bizantine është edhe ajo e opsionit të dytë, porse këtu është fjala për periudhën kohore më vonë se epoka justiniane e më parë se shekulli XIV.

E katërta, ekziston një mendim në formë supozues, se *Kalaja e Vjetër në Vushtrri ishte ndërtuar në shekullin XIV*, dhe kjo na bën të dyshojmë se ekzistonin shtresa kulturore të mëhershme.¹³ Ne mendojmë se ky opsion është e vështirë të jetë i saktë. E kemi fjalën këtu për pjesën e kohëndërtimit të shekullit XIV, por pajtohemi me mendimin se shtresat kulturore të këtij monumenti duhet të jenë më të hershme. Tani shtrohet pyetja se ku po mbështetemi ne që mendojmë se monumenti u ndërtua më herët sesa shekulli i posapërmendur. Mbështetjen e kemi në dy burime: *e para, te materiali arkeologjik, që ka dalë nga gërmimet arkeologjike, e prej tyre diçka është botuar ndokund, e diçka pritet të botohet në një të ardhme jo të largët, materiale që i kemi parë, dhe e dyta, nga njoftimi që na vjen nga udhëpërshkruesit (e kemi fjalën për shtegtarin osman të shekullit XVII, Evlija ibn Dervish Mehmed Zil-li, i njohur shkurtimisht me emrin Evlia Çelebiu). Ky i fundit, nga shtegtimi që kishte bërë në atë kohë nëpër vende të ndryshme, duke përfshirë edhe toka të shqiptarëve, dhe natyrisht që kishte qenë edhe në truallin e sotëm të Vushtrrisë, dha të dhënat e ndryshme që i kishte mbledhur dhe i kishte botuar në veprën e tij*

-
- 11 Jeton Sallahu, Burim Rexhepi, Bedri Xhema, Zahir Kastrati, “Çështje nga historia e Vushtrrisë me rrethinë deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, pjesa e parë” (Faik Konica, Prishtinë, 2017), f.55-69.
- 12 Konsultën me arkeologun Dedë Palokajn e kemi realizuar nga distanca, i cili mendon se një shkrim edhe më të pasur për *Kalanë e Vjetër në Vushtrri do ta botojë në vitin 2022 (2021)*.
- 13 Të dhënat e marra për këtë monument dhe pjesë të tjera kulturore u drejtuan nga studiuesi Haxhi Mehmetaj, i cili punoi me bashkëpunëtorë, për më shumë, shih: *IV Harta Arkeologjike e Komunës Vushtrri në Harta Arkeologjike e Kosovës II (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Instituti Arkeologjik i Kosovës, Prishtinë, 2012), f.150-151.*

të titulluar “Sijahatname”. Nga ky material kuptojmë midis të tjerave, se sulltan Murati I kishte qenë në Vuçitërnë/Vushtrri më 1389-n, (fjala është ende pa u vrarë sulltani, megjithëse nuk e dimë si ka qenë kjo e mundur, gjersa shumë burime e japin lajmin se sulltani u vra në Betejën e Parë të Kosovës, disa të tjera flasin për vrasjen pas saj, e nëse është kështu kjo do të thotë se ai ishte këtejpari para kohës së betejës,) dhe pasi e kishte pushtuar atë, ai e kishte shkatërruar *Kalanë e Vjetër* (prandaj edhe ky monument është disashtresor, do të thotë ka pasur rindërtime, ja pra pse ekziston deri më sot).¹⁴ Atëherë, nëse veç paska ekzistuar nga fundi i shekullit XIV ky monument, nuk do të thotë se u ndërtua gjatë këtij shekulli, por ai duhet të jetë ndërtuar më herët, porse shkatërrohet në këtë kohë, e më vonë siç duket ka pasur investime për ta ndërtuar përsëri.

Nga sa thamë më sipër, mund të konstatojmë se *Kalaja e Vjetër në Vushtrri*, megjithëse ende nuk ka një datim të saktë të kohëngritjes së saj, duket se ka ekzistuar që nga koha bizantine, dhe këtu e kemi fjalën për kohën para shekullit XIV.

Të dhëna të reja për Kalanë e Vushtrrisë nga burimet osmane. Shekulli XVII

Krahas të dhënave që sollëm deri tani, me rëndësi janë edhe burimet që na vijnë nga burimet osmane, kjo për shkak se Perandoria Osmane i kishte futur në kuadrin e saj edhe tokat e shqiptarëve, duke filluar nga fundi i shekullit XIV, dhe zakonisht mbaheshin shënime për ndodhitë në ato vende. Në këtë drejtim, duke u bazuar te *defterët kadastralë osmanë* mësojmë se Vushtrria/Vulçetrina/Vuçitërna ishte qendër e njësisë territoriale administrative, prandaj edhe njihej me emrin Sanxhaku i Vushtrrisë/Vuçitërnës, që përfshinte një pjesë të konsideruar të territorit të sotëm të Kosovës.¹⁵

Duke iu referuar udhëpërshkruesit të lartpërmendur të shtegtarit Evlia Çelebiu, shohim se përmendet që Vushtrria ishte qendër e sanxhakut dhe kishte *struktura muri, shtëpi një e dy katëshe të mbuluara me tjegulla*. Ai na jep informacionedhe për gjuhët që fliteshin, dhe rrjedhimisht edhe për popullsinë e këtyre vendeve. Midis të tjerave ai thotë se populli nuk

14 Hasan Kaleshi, “Kosova e Metohija n’udhëpërshkrimin e Evlija Çelebisë” në revistën “Përparimi 7-8” (Prishtinë, 1955), f.422-428.

15 İsmail Arslan, *19 Yüzyıllarında Balkanlarda Bir Osmanlı Kasabasının Sosyo-Ekonomik Yapısı: Vuçitrın, Türk Dünyası İncelemeleri Dergisi / Journal of Turkish World Studies, XII/2 (İzmir, Kış 2012), p.p. 409-424.*

fliste boshnjakisht, por fliste turqisht dhe shqip.¹⁶ Fjala ishte për kohën në kapërcim të viteve të 50-ta e në fillim të viteve të 60-ta të shekullit XVII. Nga kjo kuptojmë se popullsia që jetonte në Vushtrri ishte shqiptare, ndaj edhe fliste shqip, gjersa e fliste osmanishto-turqishten si gjuhë e pranisë së perandorisë, pa përjashtuar këtu praninë edhe të ndonjë minoriteti. Theksojmë se nuk përmendet asgjëkundi prania e aplikimit të gjuhës rasiene/serbe, e nga kjo duket se edhe prania e rasieneve/serbëve ka qenë e papërfillshme në Vushtrri, prandaj edhe udhëpërshkruesi Çelebiu nuk e zuri në gojë. Me tej ai përmend edhe lagjet që ekzistonin në Vushtrri, si: *Lagjja “Suheda”, Lagjja “Alaybegzade”, Lagjja e Vjetër, Lagjja e Epërme dhe Lagjja e Poshtme*. Pastaj, ai përmend ekzistencën e *Xhamisë së Vjetër, medresesë, lozhës-shtëpizës/ave së shkollave të dervishëve, banjon pranë gjykatës, një kala të shkatërruar* (duket të jetë fjala për monumentin që e kemi në trajtim), *një pazar të vogël, si dhe vlerëson bujarinë e popullatës, duke shtuar se janë dorëhapur, mikpritës, dhe u ofrojnë shumë kënaqësi kalimtarëve*.¹⁷

Nga shekulli XVII, po sjellim edhe disa të dhëna të tjera që kemi nxjerrë nga **Arkivi Osman i Kryeministrisë në Stamboll të Turqisë** gjatë punës sonë hulumtuese e që kanë të bëjnë me *Kalanë e Vjetër të Vushtrrisë*. Në fakt, të dhënat rrjedhin nga një dokument osman që flasin diku për vitin 1678, që do të thotë jo shumë vite pas vizitës së Çelebiut. Citojmë:

*“Guvernatorit Dervish Beu ju morë nga duart timari i katundit Yave i qytezës së Mihaliçit (Mihaliçi/Mirashi sot katund në kuadër të Komunës së Vushtrrisë, shënim i autorëve) që ishte i lidhur me Sanxhakun e Udavendigarit dhe që ishte pronë e tij. Arsyeya e marrjes së këtij timari kishte qenë masa ndëshkuese për të, ngase nuk kishte marrë pjesë në fushatën në të cilën ai kishte qenë oficer dhe nuk ishte në rrethimin e **Kalasë së Vushtrrisë**”.*

Këtu shkruhet se kalaja ishte e rindërtuar, ndërsa pak vite më herët Çelebiu na bënte me dije se ishte shkatërruar. Kështu besojmë se është fjala për Kalanë e Vushtrrisë, më shumë sesa të është fjala për ndonjë kala tjetër. Në dokument thuhet po ashtu: *“Timari i lartëcekur iu dha Yusuf Beut”*.¹⁸ Pra, nga ky dokument kuptojmë se qenka zhvilluar një betejë dhe kalaja ishte e rëndësishme gjatë zhvillimit të kësaj beteje, dhe me gjasë është fjala për monumentin që e kemi në trajtim e jo për ndonjë tjetër monument/kala.

16 Evliya Çelebi *Seyahatnamesi*, C. V, Haz: Yücel Dağlı-Seyit Ali Kahraman-İbrahim Sezgin, Yapı Kredi Yayınları, (İstanbul 2001), p. 293.

17 Ibid.

18 Për më shumë shih: Başbakanlık Osmanlı Arşivi (BOA), Ali Emiri Sultan IV. Mehmed (AE. SMMD.IV), Dosya60 Gömlek 7066. ; Në gjuhën shqipe, shih: *Arkivi Osman i Kryeministrisë (Stamboll, Turqi, 2021, G.S.)*.

Shekulli XIX

Në shekullin XIX, shohim se edhe *sallnamet* kanë qenë të rëndësishme për shtetin Osman, ngaqë kanë mbajtur evidencën për dukuritë e zhvilluara në kuadër të shtetit, e pra edhe ato të zhvilluara në Vilajetin e Kosovës, në kuadër të të cilit ndodhej edhe Vushtrria. Kësisoj, në fund të shekullit të lartpërmendur, kuptojmë se në Vushtrri ekzistonte edhe një lagje tjetër e quajtur “*Ikramiye*”, madje brenda *Kazasë së Vushtrrisë* kanë qenë 191 katunde.¹⁹ Disa të dhëna për kohën që po flasim sjell edhe libri i dijetarit Sami Frashëri, i titulluar “*Kamusu I-A lam*”, i cili përmend ekzistencën e katërmbëdhjetë *xhamive*, përfshirë në këtë numër edhe ato më modeste-*mesxhite*, dy *medreseve*, një *shkollë të mesme-rustiye*, një *shkollë filllore-iptidaiye*, **një kështjelle të rrënuar** (duhet të jetë fjala për monumentin që po e trajtojmë), një *ure të lartë muratore mbi lumin Sitnica*²⁰ (për kohën që po flasim, ne kemi dijeni se është fjala për Urën e Gurit, e cila kishte mbetur pa ujë²¹) e që përballë saj kalon edhe një *ndalesë hekurudhore* gjysmë ore larg.²² Nga këto të dhëna kuptojmë se paska ekzistuar *Kalaja e Vjetër*, por ajo ishte e rrënuar. Megjithatë, monumenti në fjalë nuk kishte qenë gjatë gjithë këtij shekulli i rrënuar, dhe këtë e kuptojmë nga një **dokument arkivor** që e kemi nxjerrë gjatë hulumtimeve tona në arkivin e përmendur më lart, dhe që ka të bëjë me datën 23 shtator të vitit 1831. Ne po e prezantojmë të shqipëruar pjesën e dokumentit që lidhet me temën që jemi duke e trajtuar. Për këtë po citojmë dokumentin:

“...kemi dërguar një sasi të ushtarëve për të marrë Kalanë e Vushtrrisë”,

ose mund të përkthetet

“...kemi dërguar një sasi të ushtarëve për të rimarrë nën sundim Kalanë e Vushtrrisë”.²³

Nga kjo del se *Kalaja e Vushtrrisë* paska ekzistuar në këtë kohë, dhe madje ndokush e paska marrë përkohësisht atë. E se kush kanë qenë ata që paskan kundërshtuar pushtetmbajtësit e kohës, për këtë dokumenti në

19 Yildirim Aganoglu *Kosova Vilayeti Salnamesi, Rumeli turkleri kultur ve dayanisma dernegi yayinlari* (Hixhri 1314, 1896, Istanbul, 2000), p. 201.

20 Şemseddin Sami, *Kâmûsü'l Alâm*, C. 6, Tıpkıbasım, Kaşgar Neşriyat, (Ankara 1996), p. 4691.

21 Jeton Sallahu, Burim Rexhepi...*opcit*, p.p.72-81.

22 Şemseddin Sami, *opcit*.

23 Başbakanlık Osmanlı Arşivi (BOA) Hatt-ı Hümayun (HAT), Dosya 433 Gömlek 21991.; Në gjuhën shqipe shih, *Arkivi Osman i Kryeministrisë (Stamboll, Turqi, 2021)*.

Për shekullin që po flasim, informacionet për *Kalanë e Vjetër* i kemi edhe gjatë viteve të **70-ta**, gjersa ishin në zhvillim luftërat osmano-ruse. Më saktësisht e kemi fjalën për vitet 1877-1878. Duket se ka pasur djegie në brendësi të objektit mbrojtës, domethënë brenda *Kalasë së Vjetër*.²⁵Kështu së paku na tregojnë disa të dhëna që vijnë nga kultura e që janë shqipëruar nga gjuha turke.

Skicë për Kalanë e Vjetër në Vushtrri

Krahas të dhënave që nxorëm deri tani në këtë shkrim për *Kalanë e Vjetër*, në Vushtrri, është me interes të prezantojmë edhe **një skicë** të cilën e kemi gjetur gjatë punës sonë hulumtuese në **Arkivin Osman të Kryeministrisë në Stamboll të Turqisë**.



Në vazhdim po prezantojmë përkthimet në gjuhën shqipe, gjersa ato në **skicë** mund të shihen në gjuhën osmane dhe turke: *Lagjja jomyslimane* (Zimmi Mahallesi), *Dera* (Kapu), *Kalaja e Vushtrrisë* (Kala-I Vulçettrin),

25 <https://kulturenvanteri.com/yer/vicitirin-kalesi> (parë për herë të fundit dhjetor 2021).

Kalaja e Brendshme (İç-Kala), *Lagja myslimane* (İslam Mahallesi), *Residencë* (Konak), *Kullë* (Kule), *Urë* (Cisr), *Përroi-lumi* (Dere), *Residencë menaxheri-Konaku i drejtorit* (Müdürü Konağı).²⁶

Ekzistenca e kësaj **skice** sikur na bën të dyshojmë se ishte planifikuar nga organet e kohës për një investim në objektin që e kemi bosht të trajtimit, megjithëse nuk i kemi të dhënat e sakta se kur planifikohej të bëhej ky investim. E njëjta gjë vlen edhe për datimin e **skicës** (sikurse nuk përjashtohet as mundësia se ekzistenca e i **skicës** thjesht ishte njoftim më i detajuar i ekzistencës së objektit, vendndodhjes së tij...). Sidoqoftë, nga sa më sipër, kuptojmë se *Kalaja e Vjetër në Vushtrri* ka shumë shtresa, gjurmë nga kohë të ndryshme, ndaj edhe investimet e ndryshme më të realizuara ndër periudha historike nuk do të thonë se ajo gjithnjë kishin qenë vetëm në truallin e sotëm të vendndodhjes së objektit, ndoshta trualli i saj mund të ketë qenë edhe më i gjerë sesa shihet sot...

Le të analizojmë edhe pak informacionet e **skicës**, duke i krahasuar me gjendjen e tanishme të Kalasë. Ekzistenca e *Lagjes jomyslimane* na lë të kuptojmë se krahas dominimit të fesë islame tk banorët e qytetit të Vushtrrisë, ekzistonte ende edhe prania e fesë së krishterë. Kjo natyrisht duhet kërkuar po ashtu te popullata shqiptare, që ka arritur të ruajë fenë nga shekujt e mëhershëm, megjithatë kjo nuk do të thotë se në Vushtrri nuk ka pasur edhe ndonjë etnitet, por duke qenë pakicë, mund t'i kenë takuar fesë së krishterë. Tani po ndalemi në disa nga objektet e dhëna më lart, si: Nisur nga ekzistenca e *derës*, domethënë hyrjes në në *Kalanë e Vushtrrisë* (*Kalaja e Brendshme*) *besojmë* se krahas asaj që shohim sot me sy për objektin, dhe duke iu referuar **skicës**, se territorialisht objekti do ketë qenë më i gjerë, ose ndoshta kështu duket në **skicë**; *Lagja myslimane*, do të thotë se emërtimi i lagjes është bërë mbi bazën e karakterit fetar-islam; *Residenca është ajo* që shihet te *Kalaja e Brendshme*; *Kulla është ajo* që shihet te *Kalaja e Vushtrrisë* dhe që zakonisht ka shërbyer për vrojtim; *Ura*, natyrisht ka qenë e domosdoshme, ngaqë në Vushtrri kanë pasur shtratin dhe kanë më shumë sesa një *lum*, e dihet se urat shërbejnë si objekte që ofrojnë njerëzit, duke tejkuluar pengesat nga ujërat; *Residenca e menaxherit*, *tregon se ka* ekzistuar hierarkia, prandaj nevojitej edhe një udhëheqje në këtë vendbanim.

26 Basbakanlık Osmanlı Arsivi (BOA), *Plan Proje ve Krokiler (PLK.p)*, *Dosya 869*; Altmiş zira osmanlı mikyastır 10-20 -60, kjo e fundit që gjendet në skicë tregon madhësinë e hapësirës për çka u bë fjalë...!

Shekulli XX

Vendbanimi i Vushtrrisë zihet në gojë në shkrimet osmano-turke edhe në fillim të shekullit XX. E kemi fjalën për një **hartë në të cilën përmendet Rajoni i Prishtinës, Vushtrrisë dhe i Mitrovicës dhe bën fjalë diku për vitin 1909.**

Nga sa u tha më sipër, mund të vijmë në përfundimin se *Kalaja e Vjetër në Vushtrri*, është një objekt me histori shumëshekullore ekzistence, e cila ka kryer funksione të ndryshme, megjithëse e dëmtuar herë pas here, madje ndonjëherë dëmi ka qenë shumë i madh dhe ajo është shkatërruar deri në themele, ose së paku kështu thonë dijetarët të cilët e kanë përmendur atë. Megjithëse, duket se ka pasur edhe ndërhyrje ndër shekuj, ajo vazhdon të jetë e ngritur në qendër të qytetit edhe në ditët e sotme. Në Kalanë e Vushtrrisë tashmë jo vetëm zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore, por ajo njëkohësisht shërben si objekt tërheqës për turistët.

Bibliografia

Burime të pabotuara

I. Arkivi Osman i Kryeministrisë në Stamboll, Turqi

1. Başbakanlık Osmanlı Arşivi (BOA), Ali Emîrî Sultan IV. Mehmed (AE.SMMD.IV), Dosya 60 Gömlek 7066.
2. Başbakanlık Osmanlı Arşivi (BOA) Hatt-ı Hümayun (HAT), Dosya 433 Gömlek 21991.
3. Başbakanlık Osmanlı Arşivi (BOA), *Plan Proje ve Krokiler* (PLK.p), Dosya 869.
4. Başbakanlık Osmanlı Arşivi (BOA), Haritalar (HRT.h), Dosya 1348.

II. Disa rezultate nga gjurmimet arkeologjike në Kalanë e Vjetër në Vushtrri

1. Sallahu, Emin (2010), Materiale të pabotuara të Kalasë së Vjetër në Vushtrri.
2. Rexhepi, Burim, (2020) Temë masteri, “Valorizimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Vushtrrisë”, Prishtinë.

III. Konsultë me profesionistë

1. Palokaj, Dedë (2021).
2. Sallahu, Emin (2021), *Materiale të pabotuara, Prishtinë*.

Burime të botuara

I. Literatura

1. Agaoglu, Yildirim (2000), *Kosova Vilayeti Salnamesi*, Istanbul.
2. Berisha, Milot (2014), “Ulpiana e Dardanisë në dritën e hulumtimeve arkeologjike” në “Gërmime dhe studime arkeologjike në Kosovë”, 2000-2012, Prishtinë.
3. Çelebi, Evliya, *Seyahatnamesi*, (2001), Istanbul.
4. Gashi, Luan (2015), “Gërmimet arkeologjike dhe konservimet në Kalanë e Vushtrrisë”, Prishtinë.
5. Grup autorësh (1979), “Ilirët dhe Iliria te autorët antikë”, Prishtinë.
6. Mehmetaj, Haxhi (2012), *IV Harta Arkeologjike e Komunës Vushtrri në Harta Arkeologjike e Kosovës II*, Prishtinë.
7. Përzhita Luan, Peja Fatmir, (2006), “Mbi disa tipare të zhvillimit kulturor në Dardaninë Perëndimore shek.I-IV” në *Harta Arkeologjike e Kosovës/Archaeological Map of Kosova I*, Prishtinë.
8. Përzhita, Luan, (2014), “Vlera kronologjike e të dhënave të Prokopit mbi ndërtimet e Justinianit në Provincën e Dardanisë” në “Gërmime dhe studime arkeologjike në Kosovë”, 2000-2012, Prishtinë.
9. Sami, Şemseddin (1996), *Kâmûsu'l Alâm*, Ankara.
10. Sallahu Jeton, Rexhepi Burim, Xhema Bedri, Kastrati Zahir (2017), “Çështje nga historia e Vushtrrisë me rrethinë deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore”, pjesa e parë, Prishtinë.

II. Revistat

1. Arslan, İsmail (2012), 19 Yüzyıl ortalarında Balkanlarda Bir Osmanlı Kasabasının Sosyo-Ekonomik Yapısı: Vulçitrın, në “Türk Dünyası İncelemeleri Dergisi”, Izmir.

2. Ceka, Nerita (1977-1978), “Vendbanime protourbane në Ilirinë e Jugut”, në revistën “Iliria studime dhe materiale arkeologjike”, Tiranë.
3. Kaleshi, Hasan (1955), “Kosova e Metohija n’udhëpërshkrimin e Evlija Çelebisë”, në revistën “Përparimi 7-8”, Prishtinë.

III. Gazetat

1. Shala, Faik (2000), “Monumentet kulturo-historike duhet të ruhen nga vetë populli”, në gazetën “Dita”.

IV. Interneti

1. <https://kulturenvanteri.com/yer/vicitirin-kalesi>